

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Analiza/ Zgjedhjet në Berlin mes radikalizimit të politikës
ADRESA	https://lapsi.al/analiza-zgjedhjet-ne-berlin-mes-radikalizimit-te-politikes-i1093646
BURIMI	lapsi.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 07:20:57 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 07:14:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	80a182cbafd771f95a3f387b3fcd1533f0c01679e0067e63d701a62d647e4511
TEKSTI	10f6e684e4c5737bc006141f32147f82fb560f203545c484bb8dc7faac628673
PAMJA	daf838096a91d0a6b68cf35820f92aebc35eb1993c28722304e93d38ea2ae6ec

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	04406bbededac16690a908f5ed750aa53744c6ef4e56ff7f392215f8287682
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	ac1c8d986ca8a5982bff13c00b3f40fb9a36fbd6d516390a812a54ba861f1b0b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/04406bbededac16690a908f5ed750aa53744c6ef4e56ff7f392215f8287682>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Analiza/ Zgjedhjet në Berlin mes radikalizimit të politikës

Kryeqyteti gjerman është gati të shkojë në zgjedhje e rezultati është i vështirë për t'u parashikuar si gjithmonë. Tre parti garojnë për vendin e parë, dy prej të cilave ndodhen në skajet e kundërta të spektrit politik.



LAPSI.AL • 14 SEPTEMBER 2026



Berlini, një qytet-land me 3,9 milionë banorë, njihet për larminë e tij, por është edhe mjaft i copëzuar nga ana sociale. Në shumë aspekte, ai ngjan me një mozaik lagjesh të veçuara, ku njerëzit rrallë lëvizin përtej zonës së tyre.

Ky copëzim shtrihet edhe në peizazhin politik të qytetit. Ndërsa lagjet qendrore të Berlinit kanë votuar së fundmi për të Gjellbrit ose për Partinë E Majta, periferitë, ku jeton shumica e berlinezëve, dominohen nga Bashkimi Kristian-Demokratik (CDU) i qendrës së djathtë dhe, në disa zona, nga Alternativa për Gjermaninë (AfD) ultra e djathtë. Kjo e bën veçanërisht të vështirë parashikimin e rezultateve zgjedhore në Berlin, sidomos vitet e fundit, kur posterët e partive po shfaqen gjithnjë e më dendur në shtyllat e qytetit gjatë fushatave elektorale.

Përpara zgjedhjeve për Dhomën e Deputetëve të Berlinit më 20 shtator, kur berlinezët do të zgjedhin parlamentin e landit që vendos se kush do të jetë Kryebashkiaku Qeverisës i ardhshëm, tri parti ndodhen praktikisht në një garë të barabartë. Partia E Majta, CDU-ja dhe AfD-ja mund të mbështeten secila në 18 deri në 20 për qind të votave, në varësi të sondazhit. Jo shumë larg tyre renditen Të Gjellbrit me 16 për qind, ndërsa Socialdemokratët (SPD), që për dekada kanë qenë forcë qeverisëse në Berlin, kanë rënë në vetëm 13 për qind.

Dy pllakate zgjedhore, i pari i partisë E Majta, i Dyti i CDU-se me kandidatet kryesore "Kjo garë po merr formën e një dueli mes CDU-së dhe Partisë E Majta" Fotografi: dts Nachrichtenagentur/IMAGO

Mbështetja relativisht më e ulët për AfD-në në Berlin bën që situata të mos jetë aq dramatike sa ishte në Saksoni-Anhalt më 6 shtator, ku përmasat e suksesit të së djathtës ekstreme e bëjnë praktikisht të pamundur përjashtimin e saj nga qeverisja. Megjithatë, një fitore e Partisë E Majta dhe një tjetër humbje për CDU-në e Friedrich Merz-it do të ndryshonin rrënjësisht peizazhin politik të Berlinit dhe do të rrisnin

ide



Ortaku besprerë i Ron Yeffetit
Andi Bushati



Insistimi tek krimi, arësyeja përse kryeministri Rama duhet të dorëhiqet
Blendi Kajsia

MOTITRANA

21°C

KËMBIMIEURO

91.94

aktuale

08:10

Shtatori ndez protestat/
Qytetarët rikthehen në shesh,
107 ditë mobilizim kundër
qeverisë

22:18



Protestuesit i zënë pritë në
rrugë Belinda Ballukut
(VIDEO)



TIA dhe Vodafone sjellin
teknologjinë Airbus në Tiranë

Ndriqe Lapsin edhe në



Me interes nga publiku



Si të zhvillohet një fushatë në një qytet të polarizuar

Kjo situatë politike e larmishme e bën veçanërisht të ndërlikuar zhvillimin e një fushate zgjedhore në Berlin, sidomos për një parti të kujdesshme dhe konservatore si CDU-ja.

"Berlini është vërtet një sfidë e veçantë", tha për DW Lukas Krieger, sekretari i përgjithshëm i CDU-së në Berlin. Krieger ndodhet në një pozitë unike për të kuptuar ndikimin kombëtar të zgjedhjeve rajonale, pasi është njëkohësisht deputet në Bundestag dhe sapo ka përjetuar rezultatin e dhimbshëm të CDU-së në Saksoni-Anhalt. Sipas tij, megjithatë, "Berlini nuk mund të krahasohet as me Gjermaninë në tërësi dhe as me Saksoni-Anhaltin".

I veshur me një kostum elegant dhe në prag të hyrjes në një mbledhje për analizimin e rezultateve zgjedhore me deputetët e CDU-së, Krieger u shpreh me besim të plotë për garën në Berlin dhe nuk kishte dyshime se kush ishte kundërshtari kryesor.

"Po bëhet gjithnjë e më e qartë se kjo garë po merr formën e një dueli mes CDU-së dhe Partisë E Majta", tha ai. "AfD-ja në Berlin nuk ka asnjë mundësi për të negociuar pjesëmarrjen në një qeveri. Nuk ka askënd që dëshiron të bashkëpunojë me të. Ne kemi një Parti E Majta shumë radikale në Berlin, prandaj themi: Berlini do të mbetet i qëndrueshëm dhe CDU-ja është e vetmja parti që garanton se qyteti do të mbetet në qendrën e spektrit politik."

Një tjetër sfidë për CDU-në e Berlinit është largimi i kryebashkiakut aktual, Kai Wegner, i cili ende mban postin, por nuk kandidon më pas një skandal që lidhej me një ndeshje tenisi gjatë ndërprerjes më të madhe të energjisë elektrike në Berlin që nga Lufta e Dytë Botërore.

Si pasojë, partia u detyrua të prezantojë me nxitim një kandidat të ri, ministrin e Financave Stefan Evers, i cili tani duhet të gjejë një rrugë politike mes dy sfidave shumë të ndryshme: AfD-së së tejmbushur me vetëbesim dhe Partisë E Majta që po fiton vull, të dyja të favorizuara për të përmirësuar ndjeshëm rezultatet e vitit 2023.

Kundërshtarja kryesore e Evers-it është gjithashtu një emër i ri: Elif Eralp, një juriste e lindur në Mynih në vitin 1980, vetëm pak javë pasi prindërit e saj ishin larguar nga Turqia pas një grushti shteti ushtarak.

Megjithatë, berlinezët janë mësuar me kandidatët për kryebashkiak që nuk janë nga qyteti. Evers i ka lindur në Nordrhein-Westfalen, ndërsa Krieger vjen gjithashtu nga Mynihu. Në fakt, sondazhet tregojnë se asnjëri prej kandidatëve kryesorë nuk është veçanërisht i njohur. Në një sondazh të fundit, rreth gjysma e banorëve të Berlinit thanë se nuk kishin ndonjë mendim të fortë për asnjërin prej tyre.

 AfD-ja në Berlin - Pllakate e AfD-se me kandidaten Kristin Brinker
AfD-ja në Berlin - Nuk ka askënd që dëshiron të bashkëpunojë me të
Fotografi: Emmanuele Contini/IMAGO

Të jesh i besueshëm dhe të ofrosh alternativa

Problemi i CDU-së është se politika gjermane po bëhet gjithnjë e më radikale, siç treguan zgjedhjet në Saksoni-Anhalt. Sipas vëzhguesve, kjo lidhet pjesërisht me dështimin e perceptuar të partive tradicionale të qendrës për të ofruar zgjidhje të reja për elektoratin. "Pyetja është: A keni propozimet tuaja politike? A po përpiqeni të fitoni dhe mobilizoni grupe të reja votuesish?", tha Julia Reuschenbach, politologe në Universitetin e Hamburgut.

Sipas saj, Partia E Majta është konsoliduar në Berlin si kundërshtarja më e besueshme e AfD-së. Kjo, pjesërisht, sepse është e vetmja forcë e rëndësishme e qendrës së majtë që nuk është e gatshme të mbështesë CDU-në, ashtu siç edhe CDU-ja nuk dëshiron të bashkëpunojë me Të Majtën.

Megjithatë, edhe Partia E Majta ka problemet e saj. Ajo vazhdon të ndiqet nga akuzat



Rama u pret fjalën banorëve të Policanit, debate me kryebashkiakun socialist dhe aktoren Egla Ceno/ Qytetarët i largohen nga takimi



Preventivët në kompjuter/ Si e zbuloi SPAK që vila në Palasë ishte e Ballukut



Protestuesit i zënë pritë në rrugë Belinda Ballukut (VIDEO)



Kurti prezanton emrat e qeverisë së re të Kosovës

për antisemitizëm, pasi një reper që performoi në një aktivitet zgjedhor në lagjen Neukölln, ku jeton një pjesë e madhe e komunitetit palestinez të Berlinit, brohoriti "Vdekje IDF-së", duke iu referuar ushtrisë izraelite. Eralp i dënoi deklaratat dhe premtoi hetim, por çështja e Gazës është bërë qendrore për shumë mbështetës të partisë. Në qershor, Partia E Majta miratoi zyrtarisht një rezolutë që e konsideron veprimin ushtarak të Izraelit në Gaza si gjenocid.

Megjithatë, Reuschenbach mendon se forca e Partisë E Majta qëndron te aftësia e saj për të propozuar alternativa konkrete politike. "Sigurisht, ato janë populiste", tha ajo. "Ata paraqesin kërkesa maksimaliste: 'Duam që pronat e mëdha private të kalojnë në pronësi publike. Duam shpronësime.' Por flasin qartë dhe drejtpërdrejt. Për shumë njerëz, E Majta paraqet më shumë qartësi dhe më shumë ide të veta."

Ajo i referohej veçanërisht kërkesës më radikale të partisë, një ide që ndodhet në qendër të debatit politik në Berlin prej të paktën pesë vitesh. Partia E Majta është e vetmja nga partitë e mëdha që premton të zbatojë rezultatin e referendumit të vitit 2021, kur 59 për qind e berlinezëve votuan për shpronësimin e kompanive të pasurive të paluajshme që zotërojnë më shumë se 3.000 banesa në qytet dhe kalimin e tyre në pronësi publike.

Që atëherë, qeveritë e Berlinit, fillimisht nën drejtimin e SPD-së dhe më pas të CDU-së, kanë vonuar vazhdimisht zbatimin e këtij rezultati.

 Elif Eralp, një juriste e lindur në Mynih në vitin 1980- kandidatja e partise E Majta - dy pllakata njera mbi tjetren në shtyllë, poshte Stefan Evers, CDU
Elif Eralp, një juriste e lindur në Mynih në vitin 1980- kandidatja e partise E Majta
Fotografi: dts Nachrichtenagentur/IMAGO

Problemi janë qiratë

Për Wolter-in, ekziston një arsye kryesore pse popullsia e Berlinit është radikalizuar dhe pse partia e saj është forcuar kaq shumë.

"Në të gjitha sondazhet, anketat dhe bisedat që kemi me votuesit, del gjithmonë e njëjta gjë: kriza e qirave është katastrofike", tha ajo për DW. "Njerëzit nuk gjejnë dot banesa, kanë frikë nga rritja e qirave dhe po humbasin apartamentet e tyre, sepse pronarët po i rimarrin ato duke iu referuar nevojave të tyre personale për banim."

Sipas një sondazhi të fundit të Berlin Trend, strehimi është tema më e rëndësishme e këtyre zgjedhjeve. Rreth 32 për qind e berlinezëve e konsiderojnë problemin më të madh të qytetit, shumë më tepër se 10 për qind që përmendin emigracionin dhe azilin ose 9 për qind që përmendin sigurinë, kriminalitetin dhe terrorizmin.

Kësaj prirjeje në rritje për ide më revolucionare mund t'i kontribuojë edhe fakti se këto janë zgjedhjet e para në historinë e Berlinit, ku mosha e votimit është ulur në 16 vjeç. Të rinjtë po politizohen gjithnjë e më shumë. "Mendoj se shumë të rinj, shumë më tepër se kur isha unë e re, shqetësohen për çështje si ndryshimet klimatike apo nëse do të kenë ende një vend pune në të ardhmen", tha Wolter. "Madje edhe për pensionet. Në një stendë informuese më erdhi një vajzë që dukej rreth 14 vjeçe dhe më pyeti për politikën tonë të pensioneve."

Sipas Wolter-it, Berlini, i cili gjithmonë ka qenë një përzierje e veçantë e konservatorizmit dhe radikalizmit, po bëhet gjithashtu gjithnjë e më i larmishëm nga pikëpamja ekonomike: "Kemi një numër në rritje milionerësh në Berlin, por edhe një numër në rritje njerëzish që jetojnë në varfëri." Pikërisht kjo e bën Berlinin një sfidë politike unike./ DW

Të këshilluara



Trafik i rënduar në Unazën e Madhe, nisja e vitit shkollor shton fluksin e automjeteve

Tirana është zoiuar këtë të hënë me trafik të rënduar në Unazën e Madhe.



me radhë të gjata aut...



AKEP ndalon klauzolat e indeksimit, rritja e çmimit të celularëve duhet të parashikohet në vlerë

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) do të ndalojë aplikimin e klauzolave të ndryshimit të tarifave, të shprehura ...



Studiuesi: Punonjësit e AI janë “realisht të frikësuar” për të ardhmen e njerëzimit



Aksident i rëndë në Turqi, autobusi përfshihet nga flakët pas përplasjes. 2 viktima dhe 8 të plagosur

Një aksident i rëndë është regjistruar në autostradën Veriore Marmara në Turqi ku një autobus që u përpl...



Shtatori ndez protestat/ Qytetarët rikthehen në shesh, 107 ditë mobilizim kundër qeverisë

Protestat kundër qeverisë vijojnë edhe këtë të hënë në Tiranë, duke hyrë në ditën e 107-të...



Plagosi me çekiç ish-vjehrrin, shpallet në kërkim daja i deputetes Zegjine Çausi

Një person ka mbetur i plagosur mbrëmjen e djeshme në fshatin Suk të Roskovecit, pasi dyshohet se është goditur me çekiç...





Sa (shtrenjtë) kushton dita e parë e shkollës? Mesatarisht 34 mijë lekë për një fëmijë



Putin: Tregtia brenda BRICS-it arrin në 1.2 trilion dollar

Presidenti rus, Vladimir Putin, ka bërë të ditur se tregtia mes vendeve të

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.